

## ***Ndërmarrja Publike Qendrore***

### ***Posta e Kosovës Sh.A.***

Në mbështetje të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe autorizimeve të dhëna nga Bordi i Dreitorëve të PK Sh.A., e me qëllim të trajtimit të drejtë, si dhe sigurimit të mundësive më të mira për të krijuar të hyra nga palët/konsumatorët e ndryshëm përmes ofrimit të shërbimeve me ndonjë bank komerciale lidhur me provizionet/komisionet Kryeshefi Ekzekutiv nxjerr këtë:

## **SHPREHJE TË INTERESIT PËR BASHKËPUNIM**

### **KUSHTET DHE KRITERET E PK SH.A. PËR OFRIMIN E MUNDËSIVE TË BASHKËPUNIMIT PËR KONTRATË –MARRËVESHJE AFATGJATE ME NDONJE BANKË KOMERCIALE**

Posta e Kosovës Sh. A. ofron mundësi bashkëpunimi për ofrimin e shërbimeve me ndonjë bank komerciale

Pasi që IFJB-ar PK Sh.A, për aktivitetin e pagesave të kryera në të gjitha Zyret Postare të licensuara, të cilat përmes Sistemit të Automatizimit të Sporteleve konvertohen në fajlat e veçantë sipas standardeve të Sistemit të Kliringut Elektronik Ndërbankar të BQK (ICS), nuk mund të raportohen direct në BQK, ngase IFJB-të nuk e kanë këtë të drejtë, por vetëm Bankat Komerciale, prandaj obligohemi që të zgjedhim një Bankë Komerciale me procedurat e shprehjës së interesit për këtë aktivitet, e cila pra luan rolin e Bankës Ndërmjetësuese në mes të IFJB PK Sh.A dhe BQK, poe edhe institucioneve tjera.

Kërkesat e PK Sh.A, të cilat duhet përmbushë Banka Ndërmjetësuese e zgjedhur janë si vijon:

1. Hapja e një llogarie bankare ku deponohen të gjitha mjetet nga pagesat e IFJB PK Sh.A, nga pagesat masive (UNIREF), dhe GIRO, nga të gjitha zyret e pagesave nëpër të gjitha komunat e Kosovës pjesët urbane dhe rurale ku ndodhet rrjeti postar.
2. Deponimet kryhen pas orarit të punës së zyrave postare, apo të nesërmen deri në ora 10:00, dhe është me rëndësi që Banka të ketë rrjetin e filijalave të veta sa më të shpërndar në të gjitha komunat e Kosovës, me qëllim të shkurtimeve të kohës dhe kostos së deponimit të mjeteve nga zyra postare në bankë.
3. Posta e Kosovës (IFJB), kërkon nga Banka, që zyrtarët Postar të trajtohen me prioritet me rastin e deponimeve, pa prituri në radhë dhe të procesohen sipas kërkesave të Postës, duke i lëshuar dokumentin përcjellës me rastin e deponimit.

4. Posta kërkon nga Banka që sipas kërkesave të kohës të kryen trajnimet e stafit apo avansimet në sistemin e raportimit sipas kërkesave të BQK ose Institucioneve të tjera ngase komunikimet si dhe avansimet në raportime gjithnjë kryhen përmes Bankës Ndërmjetësuese.
5. Posta e Kosovës, kërkon që raportimet a fajlave të pranuar nga IFJB PK Sh.A, të kryhen pa humbur kohë në sesionet e BQK-së (ICS), sipas dinamikës së pranimit të fajlave elektronike nga zyrtarët e IFJB PK Sh.A.
6. Posta poashtu kërkon që reagimi i zyrtarëve bankar me rastin e gabimeve në fajlin e pranuar nga IFJB të jetë i menjëhershëm, për të i dhënë kohë të mjaftueshme zyrtarëve të IFJB për korrigjimet eventuale dhe ridërgimin e fajlit në formë elektronike me kohë duke e nxënë sesioni e raportimit në BQK më të favorshëm (Në parim sesionin e parë të raportimit).
7. Zyrtaret e Bankës Ndërmjetësuese duhet të jenë gjithnjë në disponim (të gatshëm) të kërkesave të pranuar nga zyrtarët e IFJB-së, gjithnjë deri në përmbylljen e raporteve.
8. Banka Ndërmjetësuese merr përsipër përcjelljen e fajllit në BQK, sipas llogarive të Institucioneve të pagesave ditën e pranimit të fajllit nga IFJB PK SH.A, në sesionin përkatës të BQK, varësisht nga koha e pranimit të fajllave nga IFJB PK Sh.A.
9. Banka, poashtu duhet të mos aplikojë komisione me rastin e deponimit të mjeteve nga IFJB PK SH.A, në filialet e veta në tërë Kosovën, si dhe të aplikojë politika të favorshme me rastin e hapjes së llogarive - nënlllogarive, sipas kërkesave të Postës së Kosovës dhe dërgimin e raporteve nga gjendja e llogarisë gjithnjë sipas kërkesave nga zyrtarët e Postës, në kohën e caktuar dhe për stafin e caktuar.
10. Si Bankë Ndërmjetësuese, duhet që me kohë të i përcjellë të gjitha informatat nga Institucionet e Pagesave për IFJB PK Sh.A.
11. Poashtu sipas kërkesave të Postës së Kosovës të mundësoj hapjen e nënlllogarive për shërbime të caktuara të Postës, si dhe të sigurojë përcjelljen e raporteve nga Historiati i nënlllogarive gjithnjë sipas kërkesave-dinamikës nga zyrtarët postar dhe te mos aplikoj komisione per nenlllogari dhe transfer ndermjete llogarise kryesore dhe nenlllogarive.

#### Obligimet e Bankës Ndërmjetësuese:

1. Përcjellja elektronike e raporteve-fajllave të pranuar nga IFJB PK SH.A, me kohë në ICS të BQK
2. Kthimin e menjëhershëm të fajllave tek zyrtaret e IFJB, me rastin e gabimeve –mos pranimit në ICS , si dhe riprocedimi pavonesë pas përmirësimeve nga zyrtarët e IFJB, gjithnjë duke e nxënë sesionin e favorshëm të raportimit
3. Të sigurojë informata profesionale me rastin e kërkesave nga zyrtarët e IFJB, si për rimbursimin e mjeteve me rastin e reklamimeve nga palët apo insdtitucionet, si dhe koordinimi me zyrtarë e Thesarit të MF-ve, në këtë aktivitet.
4. Të i ofroj tarifat më ekonomike për Postën e Kosovës për pagesat MASIVE (uniref\_ bugjeti) si GIRO pagesat dhe ato massive prioritare sipas tri sesioneve të raportimit në BQK.

5. Të jetë kooperuese në të gjitha kërkesat e kohës me qëllim të avansimit të shërbimeve të ndërsjella sipas kërkesave të BQK-THESARIT dhe institucioneve tjera të pagesave.
6. Të përcjellë të gjitha mjetet në llogarin përkatëse të PK-së, pas barazimeve nga BQK, për institucionet të cilat nuk aplikojmë provizione të pagesave si psh. (KESCO-KUR-etj).

Ps: IFJB PK SH.A.ka fituar një përvojë të avansuar në aktivitetin e pagesave dhe ka avansuar formatin e komunikimit, gjithnjë sipas standardeve të BQK-së dhe në këtë rast Banka e zgjedhur nuk do të ketë probleme teknike me rastin a pranimit elektronik të informatave-raporteve-fajllave nga IFJB,

Me rëndësi është që Banka e zgjedhur të ketë mundësitë teknike për importimin me kohë të fajllave nga ne dhe të eksportojnë me kohë në sistemin e raportimit elektronik të BQK.

Në rast se Postës së Kosovës sh.a. i mundesohet raportimi direkt ne BQK atëherë marrveshja e lidhur me bankën do të shqyrtohet sipas kushteve të reja ligjore që do të krijohen.

#### **Kriteret:**

1. Bankat duhet ta dorzojnë ofertën e tyre
2. Çmimet e caktuara ne ofertë janë te negociuara.
3. Një komisioni i themeluar nga PK Sh A, do te beje vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertave me te mira dhe me te favorshme per Posten e Kosoves
4. Afatet dhe kushtet e pagesës do te jenë konform negociatave te zhvilluara.

#### **Dokumentet e nevojshme:**

- Licenca per kryerjen e shërbimeve bnkare (dokumenti kopje)
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi biznesin, (dokumenti kopje)
- Numrin fiskal (dokumenti kopje)
- Certifikaten e TVSH-së (dokumenti kopje)
- Oferta duhet të dorëzohet e mbyllur.

#### **Dokumentet e nevojshme per fituesin:**

- Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së dhenjes se Kontrates
- Vertetim (certifikatë) nga gjykata themelore departamenti per çeshtje ekonomike.

#### **Afati për dorëzimin e ofertave:**

- Afati i fundit për dozimin e ofertave është deri me datën: 17.01.2017 në ora 14:00 h  
Ndërtesa Qendrore e Postës së Kosovës sh.a , Prishtinë- Rr. 28 Nëntori nr 4. Zyra e Arhives nr 6-kati II